REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE, ZHVILLIMIT URBAN DHE RURAL
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE MJEDISIT

Nr. 8738 Prot. Lushnjë 14 / 09 / 2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK
(këtu)

"PËR MIRATIMIN E PRISHJES SË OBJEKTIT :"SHKOLLA 9-VJECARE LIRI KAZAZI" NDODHUR NË PASURINË NR.25/144 DHE KOPSHTIT NR.5 NDODHUR NË PASURINË NR.25/134, ZK 8571 ,DHE NDËRTIMI I SHKOLLËS SË RE LIRI KAZAZI DHE KOPSHTIT PËR FËMIJË ,LAGJJA 'XHEVDET NEPRAVISHTA", NJESIA ADMINISTRATIVE NR.2, BASHKIA LUSHNJE.

Të nderuar këshilltare/ këshilltarë

Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës arsimore dhe krijimin e kushteve bashkëkohore për zhvillimin e procesit mësimor parashikohet prishja dhe ndërtimi i shkollës së re "Liri Kazazi" dhe kopshtit për fëmijë.

Nga konstatimet e kryera në terren si dhe shkresa e ardhur në institucionin Bashkia Lushnjë me nr.508 prot. datë 11/09/2026 nga Zyra e Qëndrës së Arsimit, problematikat e objektit të shkollës dhe kopshtit pranë shkollës Liri Kazazi, janë si më poshtë :

1. Objektet paraqesin amortizim të konsiderueshëm si në elementët konstruktivë ashtu edhe në elementet arkitektonik ,ku ka një sistem aktiv të çarjeve të mureve të cilat janë bërë më evidente gjatë viteve.
2. Objektet kanë shërbyer si repart ushtarak rreth viteve '80. Kushtet aktuale të godinës nuk përmbushin standardet e nevojshme dhe kushtet minimale teknike dhe higjieno-sanitare në bazë të VKM nr .319, datë 12/04/2017 "Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave" për zhvillimin e veprimtarisë arsimore dhe nuk janë të përshtatshme për funksionimin e një institucioni arsimor.

Ndërhyrja parashikon ndërtimin e objektit të ri që nga themelet , duke përfshirë realizimin e të gjitha projekteve si konstruktiv, arkitektonik, elektrik, hidrosanitar, sistemi ngrohje ftohjes ,projekti i mbrojtjes nga zjarri dhe emergjencat, instalator në përputhje me kërkesat teknike dhe standardet në fuqi ,për funksionalizimin e plotë të godinës ,si dhe është parashikuar integrimi i funksionit të kopshtit në godinën e re të shkollës që do të ndërtohet , i cili aktualisht zhvillohet në një godinë të amortizuar dhe të parashikuar për prishje . Punimet përfshijnë ndërtimin dhe organizimin e ambienteve të brendshme sipas kërkesave funksionale të institucionit dhe VKM nr .319, datë 12/04/2017 "Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave", konkretisht realizimin e fasadave dhe rifiniturave të jashtme, vendosjen e dyerve dhe dritareve, sistemimi i oborrit, ndërtimin dhe pajisjen e nyjeve sanitare, realizimin e rrjetit të furnizimit me ujë dhe sistemit të shkarkimeve, instalimin e rrjetit elektrik, sistemit të ndriçimit, sistemit të ngrohjes , ftohjes, realizimin e sistemeve dhe masave të mbrojtjes nga zjarri, monitorimi me kamera.

Gjithashtu Zyra e Aseteve na informon me shkresën nr. 8587/1 prot. datë 10/09/2026 , se në bazë të Inventarit të pronave kjo godinë me emërtim "Shkolla 8-Vjeçare Liri Kazazi" ndodhet në pasurinë 25/144 Shtet, ZK 8571, lloji i pasurisë Truall,Ndërtesë, sipërfaqe trualli 670 m², sipërfaqe ndërtese 670 m² si dhe godina e kopshtit me emërtim sipas inventarit "Kopshti nr.6 pranë shkollës Liri Kazazi" ndodhet në pasurinë nr.25/134 , ZK 8571, lloji i pasurisë Truall,Ndërtesë, sipërfaqe trualli 354m², sipërfaqe ndërtese 354 m².

Gjendja e rënduar teknike e objekteve e bën të nevojshme prishjen (shembjen) e godinave ekzistuese dhe, në vijim, rindërtimin e objektit, me qëllim krijimin e një godine të re, të sigurt, funksionale dhe në përputhje me kërkesat bashkëkohore kërkohen për mësimdhëninen.

Ndërhyrja është dhe si kërkesë e bordit të prindërve dhe stafit arsimor në dëgjesat e buxhetit të vitit 2026 të zhvilluara gjatë muajit nëntor 2025.

Kjo ndërhyrje parashikohet të financohet nga fondi i Bashkisë Lushnje me vlerë 85 527 048.22

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1, shkronja b të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, nenit 4, nenit 5 pika 1.3 gërma a, nenit 12 të ligjit nr. 107 datë 31/07/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar propozojmë:

1. Prishjen e objektit ekzistues të ndodhur në pasurinë nr. 25/144, me emërtim në inventar "Shkolla 8-vjecare Liri kazazi ", e llojit ndërtesë,truall me sipërfaqe 670m² truall dhe 670 m² ndërtesë.
2. Prishjen e objektit ekzistues të ndodhur në pasurinë nr. 25/134 me emërtim në inventar "Kopshti nr.6 pranë shkollës Liri kazazi ", zk 8571,lagjja Xhevdet Nepravishta e llojit ndërtesë,truall me sipërfaqe 354m² truall dhe 354m² ndërtesë.

3. Ndërtimin e shkollës së re Liri Kazazi dhe kopshtit për fëmijë ,Lagjja Xhevdet Nepravishta ,Njesia Adm.nr.2,Bashkia Lushnje.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Konc. Ark. Alban Manoku

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Të Territorit
Ing. Ariola Beqo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK LUSHNJË

Nr. 8738/1 Prot.

Lushnjë, më 14.09.2026

PROJEKT-VENDIM

NR. 86 DATË 14/09/2026

"PËR MIRATIMIN E PRISHJES SË OBJEKTIT: "SHKOLLA 9-VJEÇARE LIRI KAZAZI" NDODHUR NË PASURINË NR. 25/144 DHE KOPSHTIT NR. 5 NDODHUR NË PASURINË NR. 25/134, ZK. 8571 DHE NDËRTIMI I SHKOLLËS SË RE LIRI KAZAZI DHE KOPSHTIT PËR FËMIJË, LAGJIA 'XHEVDET NEPRAVISHTA', NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 2 BASHKIA LUSHNJË"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ____/____/2026, sipas relacionit të paraqitur nga Drejtoria Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Mjedisit, në mbështetje të nenit 9 pika 1.2/a/c dhe neni 54, shkronja "e", të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 113, pika 2 të Kushtetutës se Republikës të Shqipërisë, nenit 4, neni 5, pika 1.3, shkronja a, neni 12, neni 22 të Ligjit nr.107 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar. Ju,

PROPOZOJMË:

I. Të miratoj prishjen e objektit shkolla 9-vjeçare "Liri Kazazi" ndodhur në pasurinë me nr. 25/144 dhe kopshti nr. 5 pranë shkollës "Liri Kazazi", ndodhur në pasurinë me nr.25/134 ZK 8571 Njësia Administrative Nr. 2, Bashkia Lushnjë.

II. Të miratoj investimin në vlerën **85 527 048.22** (tetëdhjetë e pesë milion e pesëqind e njëzet e shtatë mijë e dyzetë e tetë pikë njëzet e dy) lekë. Ky investim do të kryhet nga fondet e Bashkisë Lushnjë.

III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Policia Bashkiake, Ndërmarrja e Pasurisë Publike, Njësia Administive Nr. 2, Bashkia Lushnjë, Drejtoria e Financë-Buxhetit, Drejtoria Juridike, Prokurime dhe Aseteve.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Drejtoria e Planifikimit

Ariola Beqo

Drejtor Juridik

Bedri Hida

P. Erjeld Dhamo

KRYETAR I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJË

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com